

VENDIM
Nr.852, datë 14.12.2011

**PËR LEJIMIN E AUTORITETIT SHËNDETËSOR RAJONAL (ASHR), TIRANË, PËR
PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË PROKURIMIT ME OBJEKT “RIKONSTRUKSIONI
I URGJENCËS SË TIRANËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Autoritetit Shëndetësor Rajonal (ASHR), Tiranë, për përfundimin e procedurës së prokurimit me objekt “Rikonstruksioni i Urgjencës së Tiranës”, me fond limit 6 562 500 (gjashtë milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e pesëqind) lekë, pa TVSH, brenda datës 26 dhjetor 2011.

Brenda këtij afati përfshihen lidhja e kontratës dhe botimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar në Buletinin e Njoftimeve Publike.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha